



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 7640/1

Tirane, date 29.3./2017

Drejtuar: ZOTIT AGRON JAUPLLARI
SHOQERIA "PASHKASHESH" SHPK
BULEVARDI "ZOGU I PARE", PALLATI PRANE FAKULTETIT TE
SHKENCAVE TE NATYRES, SHKALLA E PARE, KATI I DYTE

TIRANE

Për njoftim: Z. VIKTOR TUSHAJ, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z. RAMIZ HOXHA, DREJTOR
AUTORITETI KOMBETAR PER SIGURINE DHE EMERGJENCAT NE
MINIERA (AKSEM), ISH RISHM
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim mbi fillimin e procedurave te revokimit te lejes nr.1002 date 21.03.2007.

I nderuar zoti Jaupllari,

Shoqëria "Pashkashesh" shpk, është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1002 date 23.03.2007, për mineral gurë gëlqeror ne objektin "Pashkashesh" Tirane.

Me shkresën nr.10949 date 23.12.2016 protokolluar ne Ministrisë se Industrisë dhe Energjisë me nr. 7640 date 28.12.2016, ka propozuar për revokimin e lejes nr.1002 date 21.03.2007, sepse nuk është paguar garancia financiare e rehabilitimit te mjedisit për vitin 2016 – 2017.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Afati i vlefshmërisë se lejes ka përfunduar me date 21.03.2017, sepse leja ka pasur një afat fillestar prej 10 viteve dhe sipas pikës nr.6 te nenit 24 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, duhet te kishit aplikuar 180 dite përpara përfundimit te këtij afati për marre një zgjatje afati edhe për 10 vite te tjera.

Mbështetur ne nenin 47 pika 1, germa "ç", te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", **ju njoftojmë se ka filluar procedura e revokimit te lejes nr.1002 date 23.03.2007**, për mineral gurë gëlqeror ne objektin "Pashkashesh" Tirane.

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do merret vendimi për revokimin e lejes minerare ne fjale.

Ne zbatim te nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar, duhet te rehabilitoni zonën e shfrytëzimit ne te cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NE MUNGESHE DHE ME POROSI

ZEVENDESMINISTRI

ILIR BEJTJA

